



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:268308
Datë: 01.03.2024
Numri i dokumentit: 05397248

C.nr. 1328/2022

GJYKATA THEMELORE GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Florije Qerimi, me bashkëpunëtoren profesionale Emine Hoti, në çështjen kontestimore të paditësit, Xh S nga Gj, të cilin me autorizim e përfaqëson Ymer Huruglica avokat nga Gjilani, kundër të paditurit F S nga Gj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Sejdiu & Qerkini sh.p.k, avokat Burim Azemi nga Prishtina, me objekt kontesti Pengim posedimi, pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor me datë 29.01.2024, dhe pas pranimit të shpjegimeve përfundimtare, më datë 19.02.2024 përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh S nga Gj, dhe VËRTETOHET se i padituri F S nga Gj, me datë 02.12.2022 dhe në vazhdim e ka penguar paditësin në posedimin faktik dhe juridik të ngastrës kadastrale nr.4...10, cila gjendet në vendin e quajtur “Livadhet e Arapit”, me sipërfaqe prej 4269 m², Zona Kadsatrale Gjilan në shfrytëzimin e rrjetit të kanalizimit, si e drejtë e rezervuar me rastin e privatizimit të pronës nga AKP-ja, ashtu që i padituri nuk e ka lejuar paditësin që të bëjë kyqjen në rrjetin e kanalizimit dhe vendosjen e një pusete në pjesën ku bëhet kjo kyqje .

II. OBLIGOHET i padituri F. S.i nga Gj., që si shfrytëzues për 99 vite i ngastrës kadastrale 4945-9, Zona Kadastrale Gjilan, në vendin e quajtur “Livadhet e Arapit”, me kultur ndërtimore, që të mos e pengoj paditësin Xh. S. nga Gjilani, në vendosjen e pusetës dhe kyqjen sipas standarteve në kanalizimin pranë kompleksit të ish Kombinatit të Tekstilil në Gj., në atë mënyrë që të vendos pusetën nga Kompania “ H..”, e pastaj ta bëjë edhe kyqjen në rrjetin e kanalizimit egzistues sipas të njëjtave standarte.

III. OBLIGOHET i padituri F. S. nga Gj., që paditësit Xh. S. nga Gj., t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1,261.00 €, të gjitha këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim, ka paraqitur padi kundër të paditurit me objekt kontesti pengim posedimi.

Pretendimet e palëve ngërgjyqëse:

Paditësi në padi, precizim të padisë, gjatë shqyrtimeve gjyqësore si dhe në shpjegimet përfundimtare, përmes të autorizuarit të tyre kanë deklaruar se në kuadër të Qendrës Tregtare “G. C.” në Gj., pronar i së cilës në bazë të çertifikatës së pronës nr.141429-22 të datës 12.12.2022, është paditësi si pronar faktik dhe juridik i ngastrës kadastrale nr...-10 ZK-Gj., në bazë të kontratës për transferin e pronës së paluajtshme nr.174/2009 e datës 26.06.2009 në formë të qira mbajtjes për 99 vite, dhe se në kuadër të ngastrës kadastrale të lartëcekur ka marr leje ndërtimi më datë 11.11.2021 për rrënimin dhe ndërtimin e një qendre të re tregtare, pjesën e së cilës e ka rrënuar dhe ka filluar ndërtimin e saj dhe ende është në ndërtim e sipër. Ka theksuar se duke marr parasysh faktin se në kuadër të qendrës tregtare është i ndërtuar edhe rrjeti i kanalizimit dhe rrjeti i ujësjellësit, paditësi në interes të ndërtimit të objektit të lartëcekur nga Kompania Rajonale për ujë dhe kanalizim “H.” Sh.A, Gj., ka marr pëlqim me nr.1170 të datës 21.10.2021, sipas të cilit pëlqim i është dhënë për qasje në rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, për objektin me destinim komercial që planifikohet të ndërtohet në parcelat sikur në pëlqim, e në të cilat parcela, përfshihet edhe ngastra e lartcekur, meqë sipas kontratës për transferin e pronës së paluajtshme, paditësi është pronar edhe i ngastrave kadastrale 4945-12,13 dhe 14 ZK Gjilan. Tutje ka shtuar se në ish ndërmarrjen shoqërore “I.” në Gjilan, rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit kanë qenë të vendosura që në kohën e ndërtimit të kësaj ndërmarrje shoqërore, siq vërtetohet edhe përmes ortofotos të vitit 2005, kur ish NSH “I.” në Gjilan, është vënë në ankand publik për shitje, prandaj sipas deklarimit të transferit nga AKM-ja, nr.327/2006 e datës 02.03.2006, ujësjellësi, kanalizimi, e drejta në servitut dhe në energji elektrike, janë të drejta të rezervuara prandaj sipas kontratës për transferin e pronës së paluajtshme më numër të cekur më lartë të datës 26.06.2009, edhe atë në faqën e 2-të pasusin e V- të kësaj kontrate, janë konstatuar të drejta e rezervuara dhe servitutet që në kuadër të ngastrave kadastrale përmes të cilave janë konstatuar se cilat nga parcelat e privatizuara përfshihen të drejtat e rezervuara, duke përfshirë edhe ujësjellësin dhe kanalizimin, është edhe ngastra kadastrale e të paditurit 4945-9 Zona Kadastrale Gj., arsye kjo që shfrytëzuesit e këtyre ngastrave të mos e pengojnë njëri tjetrin në shfrytëzimin e të drejtave të rezervuara, ndërkaq në anekset e kësaj kontrate, duke përfshirë edhe cdo kontratë që janë lidhur rreth privatizimit në kuadër të kompleksit të ish NSH “I.” në Gj., janë konstatuar se këto të drejta të rezervuara, nëpër cilat ngastra kadastrale përfshihen, ku një konstatim i tillë i ngastrave kadastrale është edhe në kontratën e të paditurit, përkatësisht edhe në atë kontratë është përfshi edhe ngastra kadastrale e paditësit. Ka shtuar se në anekset e kësaj kontrate dhe të secilës kontratë tjetër, janë rregulluar të drejtat e rezervuara dhe lehtësimet, për cka secili nga personat që kanë privatizuar pronë në ish ndërmarrjen shoqërore të lartëcekur, gjatë veprimtarisë së tyre kanë të drejtë, jo vetëm në shfrytëzimin e pa penguar të të drejtave të rezervuara por edhe të ndërmarrin veprime që kanë të bëjnë me riparimet, përmësimin apo cdo veprim tjetër në interes të funksionimit normal të këtyre të drejtave, por gjithnjë me obligim që cfarëdo veprimi që ndërmarrin pas riparimit të kthejnë në gjendjen e mëparshme. Duke vepruar paditësi sipas pëlqimit të marr nga KRU “H.”, pasi që rrjetin e ujit dhe të kanalizimit e menaxhon e njëjta, si dhe duke u nisur nga fakti se paditësi i ka shtrirë disa gypa, vazhdimisht kompania është dashur të intervenoj në evitimin e mbylljes së gypit përfundimtarë, paditësi me pëlqimin e kompanisë ka vendosur gypa me kapacitet më të lartë, dhe atë duke filluar nga puseta që gjendet në

ngastrën kadastrale 4945-8 me kulturë rrugë, që edhe më tutje evidentohet në emër të ish NSH “Intexh” e deri në kufirin e ngastrës së të paditurit me një gjatësi prej 11.57 metra dhe duke vazhduar për 35.19 metra deri në pusëtën tjetër, përmes ngastrës kadastrale të të paditurit. Ka theksuar se me rastin e vendosjes së gypave, KRU “ H...” në G., duke u mbështetur në pëlqimin që e ka marr paditësi në këtë kompani, hapjen e kanalizimit dhe vendosjen e gypave e ka menaxhuar se një veprim i tillë a është duke u kryer sipas standarteve që i ka përcaktuar kjo kompani, duke përfshirë edhe kycjen në pusëtën që gjendet në ngastrën kadastrale 4945-8.

Mirëpo pas vendosjes së gypave, mbylljes së kanalit, në momentin e kyçjes në pusëtën e fundit paditësi është penguar nga i padituri që të bëjë kyçjen në këtë pusëtë edhe atë më datë 02.12.2022, për çka edhe ka qenë i detyruar që të ushtroj padi për pengim posedim dhe e tërë kjo ka ndodhur për faktin që me rastin e vendosjes së gypit të fundit deri në pusëtën e fundit, punë kryerësi i angazhuar nga paditësi për vendosjen e këtyrë gypave, i ka dëmtuar të paditurit disa blloka meqë aty gjendet një mur, duke përfshirë edhe një pjesë të themelit të këtij muri, meqë gypat është dashur të futen në themel të këtij muri, fakt ky që vërtetohet edhe në fotot e propozuara si prova. Ka shtuar se meqenëse kapaciteti i gypave të vendosur nga paditësi ka qenë më i madh në krahasim me gypat ekzistues, paditësi ka qenë i detyruar që edhe një pjesë të pusëtës ta zgjeroj dhe sic u theksuar më lartë pas riparimit të kësaj pusete ku është zgjeruar e njëjta, në momentin e kyçjes i padituri nuk e ka lejuar këtë dhe punëtorët e të paditurit në shenjë revolte B.. A.. dhe I.. D. e kanë dëmtuar tërësisht pusëtën, për çka të njejtit me aktgjykimin e kësaj gjykate Pnr.../23 të datës 04.04.2023, edhe janë shpallur fajtor dhe janë gjykuar me udhër ndëshkimor, si dhe ndaj paditësit është ngritur aktakuzë.

Faktin se paditësi nuk i është lejuar që të kyçet në rrjetin e kanalizimit, KRU “ H...” kanë dal në vendin e ngjarjes dhe kanë bërë lidhje të parakohshme ku sipas dëshmitarit E.. Sh., nuk është bërë sipas standarteve, meqë punëtorët e të paditurit e kanë dëmtuar pusëtën dhe pa vendosjen e kësaj pusete, është e pamundur që të bëhet kyçja sipas standarteve të përcaktuara nga kompania që menaxhon ujësjellësin dhe kanalizimin. Kyçjen në rrjetin e kanalizimit nga kjo kompani e kanë bërë gjatë zhvillimit të procedurës, pasi që është vlerësuar që përbën rrezik potencial, jo vetëm për hapjen e ndonjë epidemie, por edhe mundësinë që kalimtarët e rastit e sidomos fëmijët, të bijnë në hapësirën ku ka qenë e vendosur puseta, e cila është dëmtuar nga punëtorët e të paditurës.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të specifikuara dhe për përpilimin e padisë 104.00 € per taksë gjyqësore 50.00 €, për përpilimin e ekspertizës gjeodezike shumë prej 162.00€, dhe për shtatë seanca gjyqësore të mbajtura nga 135.00 € për seancë në shumë prej 945.00, e në shumë të përgjithshme prej 1,261.00€.

I padituri si në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore si dhe në shpjegimet përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që ka kërkuar që e njëjta të refuzohet si e pabazuar për shkak se pretendon se paditësi nuk ka dëshmuar se plotëson as prezumimet procedurale për të zhvilluar këtë çështje, fjala është për legjitimitetin real aktiv dhe kjo me faktin se ai me asnjë provë të vetme nuk e ka dëshmuar se ka ndonjë të drejtë subjektive në pronën e të paditurit. Tutje ka theksuar se në këtë rast kemi të bëjmë më një paluajtshmëri ku nënkuptohet se të drejtat e subjekteve të së drejtës mbi atë paluajtshmëri duhet të regjistrohen dhe të jenë të evidentuara në certifikatën e pronësisë, duke shtuar se nga ekspertiza

e gjeodezisë është vërtetuar se i padituri është pronar i vetëm i ngastrës kadastrale 4945/9 dhe se asnjë person tjetër nuk ka asnjë të drejtë tjetër subjektive mbi pronën 4945/9. Ka shtuar se paditësi nuk ka asnjë të drejtë të regjistruar në regjistrin e të drejtave pronësore, legjitimitetin e tij është muduar ta përmbush me anë të deklaratës për bartje nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit si dhe nga kontrata e bartjes, por që këto prova nuk janë të plota, pasi që paditësi ka paraqitur tek këto akte ka paraqitur vetëm disa faqe të tyre të cilat ka menduar se i përshtaten, e që aktet juridike duhet të paraqiten si të plota sepse me dispozitat e atyre akteve juridike si tërësi, rregullojnë çështjen e caktuar juridike sic është në këtë rast bartja e ngastrës. Lidhur me të lartëcekurat ka theksuar se është vërtetuar se paditësi pa asnjë leje ka hyr në pronën e të paditurit (këtë fakt e ka pranuar vetë, gjatë dhënies së dëshmisë) në të cilin ka krijuar rrjet të ri të kanalizimit si dhe ka dëmtuar pronën e të paditurit dhe meqë i padituri nuk jeton në atë ngastër në momentin kur ka vërejtur këtë hyrje të paligjshme ka reaguar dhe ka shmangur cdo cënim të pronës së tij dhe personat dhe sendet. Ka theksuar se nga të lartëcekurat vërtetohet se padia dhe kërkesëpadia e padiësit nuk i përmbush prezumimet procedurale dhe se e njëjta poashtu është e pabazuar.

Andaj ka kërkuar nga gjykata që të merr aktvendim dhe të hedhet poshtë padia e padiësit të paraqitur ndaj të paditurit, për shkak të mungesës së legjitimitetit aktiv ose aktgjykim dhe të refuzohet padia dhe kërkesëpadia e padiësit si e pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar të specifikuar dhe atë për përgjegje në padi shumë prej 104.00euro, për kundërshtimin në propozimin për caktimin e masës së sigurisë shumë prej 104.00 euro, për përgjegje në ankesë ndaj aktvendimit për refuzim të masës së sigurisë shumë prej 104.00 euro, për 6 seanca të mbajtura dhe atë 4 seanca të mbajtura lidhur me padinë për pengim posedim, dhe 2 seanca të mbajtura për masë të sigurisë, nga 135.20 për seancë, gjithsej 811.20 euro, për një seancë të shtyrë shumë prej 67.60 euro, dhe për përpilimin e fjalës përfundimtare shumë prej 104.00 euro, në shumë të përgjithshme prej 1.294.80

Gjendja faktike e vërtetuar:

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, Gjukata e ka administruar Pëlqimi i lëshuar nga Kompania Rajonale për ujë dhe kanalizim Hidromorava më nr. të protokollit 1170 të datës 21.10.2021; Vendimi për leje ndërtimi i lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm e datës 11.11.2021; 7 foto të formatit A4 të cilat janë bërë në vendin e ngjarjes; Çertifikata e pronës me nr.141429-22 për njësinë kadastrale 04945-44, 04945-8,04945-5, 04945-10 të lëshuara nga Zyra Kadastrale në Gjilan; Marrveshja në mes të palëve Agjensisë Kosovare të Privatizimit e datës 26.09.2009; Deklarata për bartje nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit lidhur me bartjen e pasurisë së paluajtshme e datës 02.03.2006, ku i është bashkangjitur lista me nr.3 të drejtat e rezervuara dhe lehtësimet; Konstatimi i ekspertit gjeodet Artan Zeneli e datës 06.12.2023; Aktakuza mr nr.PP.II.nr.2260/2022 e dt. 21.12.2022 e ngritur nga PTH në Gjilan; Aktgjykimi me nr.P.nr.218/2023 i datës 04.04.2023 i nxjerrë nga Gjukata Themelore në Gjilan; Deklarata padiësit Xh.. S.. e dhënë në cilësi të palës në procesverbalin e kësaj gjykate të datës 29.01.2024, Deklarata e dëshmitarit E.. Sh.. e dhënë në procesverbalin e kësaj gjykate të datës 19.01.2024.

Nga Pëlqimi i lëshuar nga Kompania Rajonale për Ujë dhe Kanalizim Hidromorava me nr të protokollit gjykata ka vërtetuar faktin se paditësit i është dhënë leje për qasje në rrjetin e ujësjellësit dhe të kanalizimit për objektin për destinim komercial që planifikohet të ndërtohet në parcelën 04945-12, 04945-10, 04945-14, 04945-13, e evidentuar në Certifikatën e pronësisë me nr të lëndës 122342-21 të datës 12.10.2021.

Nga vendimi për Leje Ndërtim i lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit, gjykata vërtetoi faktin se paditësit i është lëshuar Leje Ndërtimore për parcelat kadastrale P-70403013-04945-10; 04945-12; 04945-12 dhe 04945-14, dhe i është lejuar ndërtimi i objektit të kategorisë së dytë (II) me dimensione dhe etazhitet Qendra Tregtare Calabri, me etazhitet B+P+2 në sipërfaqe ndërtimi gjithsej 40.073m², tek vendi i quajtur PZHU “Qyteti i Gjilanit 2006-2015” Gjilan.

Nga Certifikata e pronësisë nr. 141429-22 e dt. 12.12.2022, gjykata vërtetoi faktin se parcela kadastrale me numër P-70403013-04945-10, ZK Gjilan, ka sipërfaqe 4269 m², lloji i shfrytëzimit të parcelës “Tokë Ndërtimore”, shfrytëzimi actual i parcelës “Oborr”, dhe evidentohet në emër të Xh... si qirambajtës 99 vite me 1/1 pjesë të pronës.

Nga Deklarata për bartje nga Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit lidhur me bartjen e pasurisë së paluajtshme e datës 02.03.2006, ku i është bashkangjitur lista me nr.3 të drejtat e rezervuara dhe lehtësimet: gjykata vërtetoi faktin në këtë deklaratë në pikën 1 faqe 10 është përcaktuar se këto të drejta dhe lehtësime që janë në vijim janë të rezervuara nga patundshmëritë të Ndërrmarrjeve Shoqërore dhe për të gjithë personat tjerë të autorizuar nga NSH-ja për të mirën e trojeve dhe të cdo pjese të saj dhe paragrafi 1.3 përcakton të drejtën e përhershme të plotë dhe guximin të hyj rrugës dhe të pronës së paluajtshme me punëtorët dhe paisje të tjera të gjitha të nevojshme për qëllimet të mirëmbajtjes dhe riparimin e rrugës dhe kanaleve.

Me ekspertizën e ekspertit gjeodet e datës 05.12.2023, gjykata e vërtetoi faktin se ngastra P-70403013-04945-9, me sipërfaqe të përgjithshme prej 24614m², vendi “Livadhet e Arapit” ZK Gjilan, evidentohet në emër të PSH “*Industria e Tekstilit Integ*” me pjesë të pronësisë 1/1, me të drejtën e shfrytëzimit për 99 vite F. (S.) S., sipas gjendjes zyrtare në lindje kufizohet me parcelën nr.4952-1 në gjatësi 142.88m nga pika 10 deri 11, 32.39m nga pika 9 deri 10, 75.56m nga pika 8 deri 9 dhe në gjatësi 53.28m nga pika 7 deri 8. Në jug kufizohet me parcelën nr.2541-0 në gjatësi 46.33m nga pika 6 deri në 7, me parcelën nr.4945-4 në gjatësi 153.10m nga pika 5 deri në 6. Në përfundim kufizohet me parcelën nr.4945-11 me gjatësi 26.75m nga pika 5 deri në 17, me parcelën nr.4945-8 në gjatësi 35.95m nga pika 16 deri në 17, në gjatësi 138.82m nga pika 15 deri 16, në gjatësi 7.53m nga pika 14 deri 15, me parcelën nr.4945-6 gjatësi 12.92m nga pika 13 deri 14 dhe në gjatësi 32.30m nga pika 12 deri 13. Në veri kufizohet me parcelën nr.4945-7 në gjatësi 89.95m nga pika 11 deri 12. Sipas gjendjes faktike në këtë parcelë ka të ndërtuara disa objekte.

Sipas përshkrimit të parcelës P-70403013-04945-10, me sipërfaqe të përgjithshme prej 4269m², vendi “Livadhet e Arapit” ZK Gjilan, evidentohet në emër të Xh. S. si qirambajtës për 99 vite me pjesë të pronësisë 1/1, sipas gjendjes faktike në lindje kufizohet me parcelën

nr.4945-11 me gjatësi 44.24m nga pika 2 deri në 3, në jug kufizohet me parcelën nr.4945-12 në gjatësi 87.58m nga pika 3 deri në 4. Në perëndim kufizohet me parcelën nr.2714-0 në gjatësi 47.81m nga pika 1 deri në 4. Në veri kufizohet me parcelën nr.4945-5 në gjatësi 87.66 nga pika 1 deri 2. Sipas gjendjes faktike në këtë parcelë është një objekt i cili është në ndërtim e sipër objekt i cili shtrihet në parcelat tjera 4945-12.

Sipas eskpertzës është konstatuar se fundi i gypit ndodhet në parcelën nr.4945-9 në anën veriore të kësaj parcele. Ka konstatuar se puseta ndodhet në parcelën nr.4945-8 në anën veriore të kësaj parcele. Në terren thuhet se fundi i gypit ku ka qenë i pambuluar në afërsi të murit (muri i objektit të rrënuar të ndërtuar në parcelën nr.4945-9) është i lidhur me pusetën e cila ndodhet në parcelën nr.4945-8. Distanca në mes të pusetës dhe fundit të gypit është konstatuar se është në gjatësi 46.76m. Pjesa e gypit e cila ndodhet brenda parcelës nr.4945-8 është në gjatësi 11.57m dhe pjesa tjetër e gypit e cila ndodhet brenda parcelës nr.4945-9 është në gjatësi 35.19m.

Nga Aktakuza nr nr.PP.II.nr.2260/2022 e dt. 21.12.2022 e ngritur nga PTH në Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se ndaj paditësit është ngritur aktakuzë për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 të KPRK-së

Nga aktgjykimi Pnr.218/2023, është pranuar kërkesa për dhënien e urdhërit ndëshkimorë me shenjën PP.II.nr.287/2023 të datës 27.03.2023 ndaj të pandehurve I. D. nga fsh.U. dhe B. A. nga fsh.M. e E., për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe janë dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 150.00€, për secilin veç e veç për shkak të njejtit më datë 21 janar 2023, rreth orës 12.27min në rrugën “ Lidhja e Prizrenit” në Gj., përkatësisht afër fabrikës RC Cola dhe marketit “Interex”, të pandehurit e me dashje dhe në bashkëkryerje kanë bërë dëmtimin e pronës së huaj, ashtu që të njejtit me përdorimin e kazmës e kanë dëmtuar pusetën dhe gypin e kanalizimit prej materialit të betonit, përmes të cilit rrjet i dëmtuari Xh. S. ka qenë i kyqur në rrjetin e kanalizimit me të cilin rast të njejtit i është bllokuar rrjeti i kanalizimit dhe ujërat e zeza kanë filluar që të rrjedhin në sipërfaqë, kështu që të pandehurit me veprimet e tyre të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm në vlerë të papërcaktuar materiale.

Nga deklarata e paditësit Xh. S. të dhëna në cilësi të palës, në procesverbalin e kësaj gjykate të datës 29.01.2024, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka deklaruar se është pronar i ngastrës kadastrale 4945/10, ku në këtë ngastër është Qendra Tregtare “Grande Calabria” dhe në të njëjtin vend kanë aplikuar për leje ndërtimi e cila i’u është dhënë nga Komuna me sipërfaqe prej 40mijë m2, në të cilin vend objektet janë në ndërtim e sipër. Ka theksuar se si pronar apo shfrytëzues për 99 vitë nuk është vetëm paditësi, por ka disa parcela që janë parcelu dhe janë privatizu dhe tash ka pronar të ndryshëm në këto parcela, megjithatë infrastruktura e brendshme egzistuese e cila ka qenë ajo përsëri edhe me anekset e bartjes së privatizimit secili nga pronarët e gëzojnë të drejtën e shfrytëzimit të pjesëve egzistuese që janë të përbashkëta që gjatë transferit shihet qartë cka përshinë ku parcela 4945/8 është rrugë në bazë të fletësposeduese, ajo është pjesë e përbashkët e të gjithë qirambajtësve të cilët tani janë pronarë, dhe me rastin e transferimit të pronës nga AKP-ja tek paditësi janë përsëri ngastrat si

të drejta të rezervuara në kontratë, ku edhe pronari i ngastrës kadastrale 4945/9 pronar i të cilës është F. S., i ka të drejtat e rezervuara në të njejtën kontratë. Fillimisht ka theksuar se ka bërë kërkesë tek Kompania “H.” meqenëse aty ka egzistuar kanalizimi lidhur me të cilin kanë pasur probleme për shkak të mbylljes së kanalizimit dhe vëllimit të madh të përdorimit për me i vendos gypat dhe të njejtën vijë e kanë ndjekur çdo herë për vendosjen e gypave të rinj për kyqje, dhe meqenëse gypat egzistues janë mbyll shpesh dhe janë detyruar shpesh me njoftu Kompaninë “ Hidromorava” me qëllim të intervenimit për zhbllokim të gypave, dhe kjo ka qenë arsyeja për çka paditësi ka investuar 60 mijë euro për funksionalizimin normal të asaj rrjedhe të kanalizimit, ku i ka vendos gypat e kapacitetit më të madh që të mos ketë probleme në të ardhmën. Gjatë vendosjes së gypave ka deklaruar se nuk e ka penguar askush, vetëm në momentin e kyqjes të puseta egzistuese ka pas pengesa. Gjatë vendosjes së gypave ka theksuar se ka marr udhëzime nga Kompania “Hidromora” që ta ndjek trasenë egzistuese dhe atë që e ka dëmtuar ka qenë një muri apo 5 apo 6 blloka të cilën në bazë të marrveshjes së AKP-së çdo dëm i shkaktuar duhet ta kompenzojnë dhe ta kthejnë në gjendjen e mëparshme, të njejtën nuk e ka kthyer në gjendjen e mëparshme pasi që janë në procedurë penale. Tutje ka theksuar se kyqjen në rrjetin e kanalizimit e ka bërë Kompania “Hidromorava” dhe në momentin e kyqjes kanë has në pengesa nga pronari Faton Sylejmani, i cili ka ngrit shqetësimin e vet pse po e bën kyqjen, dhe i njejtë pas pengimit për kyqje e ka dëmtu pusetën përkatësisht punëtorët e tij dhe në momentin e vërejtjes nga ana e paditësit i ka njoftu policinë të cilët edhe janë shpallë fajtor. Gjatë shtrirjes së gypavë kanë qenë nën kontroll të Kompanisë “ Hidromorava”, të cilët i kanë kontrollu edhe a po i përmbahen trases egzistuese. Gjatë vendosjes së gypave paditësi e ka dëmtuar pusetën, dhe pas kyqjes, pusetën egzistuese e kanë demolu në tërësi dhe e njejtë paraqet rrezik për fëmijët, pasi që është afër qerdhja. I njejtë ka theksuar se edhe më herët ka pas probleme me rrugën por që AKP ka dhënë sqarime me shkrim dhe pastaj edhe gjykata ka dhënë vendim final që ka të drejtën e shfrytëzimit. Kyqja është e përkohshme pasi që i padituri i ka detyru puntoret tij që ta dëmtojnë pusetën . Ka shtuar se pengim posedimi është në vendosjen e pusetës dhe i padituri e pengon Kompaninë “Hidromorava” në vendosjen e pusetës. Sipas kontratës dhe të drejtave të rezervuara në rrjetet egzistuese, sic është uji, kanalizimi, rryma e gëzojmë të drejtën që të bëjmë intervenime dhe pas shkaktimit të dëmit ti riparojmë ato dëmtime, ta kthejmë në gjendjen e mëparshme. Paditësi ka deklaruar se prej datës 30.11.2022 ka qenë i penguar për tu kyq në pusetë, po me këtë datë e kam dëmtu murin e të paditurit dhe një pjesë të temelit, ndërsa më datë 02.12.2022, ka qenë i penguar në kyqje në pusetë.

Nga deklarata e dëshmitarit E. Sh. të dhëna në procesverbalin e kësaj gjykate më datë 19.01.2024 , gjykata ka vërtetuar se i njejtë punon në Kompaninë “ Hidromorava” dhe merret me mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe ujit, dhe i njejtë në lidhje me kanalizimin në kuadër të Kombinatit të Tekstilit, ka theksuar se kanalizimi ka qenë i vjetër prej kur është ndërtu objekti PSH “ Industria e Tekstilit Integj”, ashtu edhe objektet përreth të reja të privatizuara, ku ka theksuar se paditësi ka bërë kërkesë në Kompaninë “Hidromorava”, ku me kërkesën e tij kanë dal në vendin e ngjarjes, në të cilin ka egzistuar më herët rrjeti i vjetër i kanalizimit por ka qenë gypi që nuk ka pas mundësi me iu përballu ujërave të kanalizimit dhe i njejtë për shkak të gypit është blloku ku të njejtit është dashtë me ndërhy çdo javë dhe se me pëlqimin e tyre paditësi i ka heq gypat e vjetër dhe i ka vendos gypat me të gjerë dhe pusetat i ka vendos sipas

standartit çdo 30 m që preferohen me intervenu. Lidhur me vendosjen e gypave kanë pas kërkesa nga qytetarët se puseta që e ka vendos paditësi ka qenë e dëmtuar, por se kush e ka dëmtuar nuk kanë njohuri. I njëjti tutje ka shtuar se nëse ka egzistu rrjeti i kanalizimit nuk marrin pëlqim nga pronarët e tokave, ndërsa nëse nuk ka pas rrjet të kanalizimit duhet të pyeten pronarët. Gjatë punimeve të vendosjes së gypave të cilën e ka mbikëqyr edhe dëshmitari nuk ka ndërhyrë ndonjë pronar. Ky gyp ka theksuar se lidhet me çerdhen e fëmijëve, me qendrën tregtare “ETC” dhe lidhet me gypin e qytetit kryesor. Tutje ka shtuar se kanë marr informacion së është dëmtu puseta por kush e ka dëmtu nuk kanë njohuri, dhe se paraqet rrezik dëmtimi i kësaj pusete për njerëzit dhe kafshët, dhe në rastet e dëmtimit të pusetave është detyrë e kompanisë me rregullu pusetën, edhe në rastet kur pengon pronari që të rregullohet, në rastet kur ka egzistu puseta kompania duhet të ndërhyj për ta rregulluar. Dhe në rastet kur kanalizimi është jashtë objektit e kanë për detyrë të ndërhyjnë ndërsa brenda objektit jo, vetëm nëse kalon kanalizimi nëpër oborr atëherë është obligim i kompanisë që ti mirëmbajë dhe i faturohet cdo konsumatori në emër të kanalizimit 2.40 euro. Ka theksuar se paditësi nuk pa pas zgjidhje tjetër të kyqjes së kanalizimit, në rrjetin e vjetër ska pas mundësi me u lidh dhe ramja e ujit nuk egziston në pjesë tjera dhe pusetat e ujit janë dy metra në thellës dhe 1m gjerësi janë të vendosura dhe e vetmja mundësi është që të kaloj përmes kanalizimit të vjetër. Gypin kryesor ka theksuar se e kanë lidhur por meqë palët kanë qenë në procedurë gjyqësore dhe meqë kanalizimi funksionon por vetëm puseta është dëmtuar.

Baza ligjore

Gjykata deri te vendosja si në dispozitiv të këtij aktvendimi, erdhi duke u bazuar në dispozitat ligjore nga Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, i cili në nenin 111, paragrafi 1 ka përcaktuar se *“Personi i cili e privon nga posedimi poseduesin ose e pengon në posedim kundër vullnetit të poseduesit vepron kundërligjshëm, përveç nëse privimi ose pengimi lejohen shprehimisht me ligj”*; neni 113, paragrafi 2 se *“Nëse poseduesi pengohet në posedim në mënyrë të kundërligjshme, atëherë poseduesi mund të kërkojë nga penguesi mënjanimin e pengesave. Nëse priten pengime në të ardhmen, poseduesi mund të kërkoj mbrojtje gjyqësore”*; neni 114 se *“Kërkesa mund të parashtrohet vetëm në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi që poseduesi e merr dijëni lidhur me privimin apo pengimin e posedimit të tij. Kërkesa shuhet pas kalimit të një viti nga privimi ose pengimi i posedimit”* dhe nga Ligji për Procedurën Kontestimore, i cili në nenin 480 ka përcaktuar se *“Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfundohet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfundohet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrohet kërkesa për shpërbllimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit”*.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata deri te vendosja si në këtë dispozitiv ka ardh duke u bazuar në faktet e pohuara të palëve gjatë këtij kontesti, faktet vendimtare të cilat si të vetme shqyrtohen në raste e pengim

posedimit, provat e administruara si më lartë dhe bazën ligjore nga neni 111 dhe 113 të LPTDS-së lidhur me nenin 480 të LPK-së.

Gjykata paraprakisht ka shqyrtuar afatshmërinë e kërkesëpadisë së paditësve për pengim posedim dhe ka gjetur se e njejta është e afatshme, përcaktuar si në nenin 114 të LPTDS-së, pasi pengimi i posedimit ka ndodhur më datë 02.12.2022, ndërsa padia është ushtruar më datë 15.12.2022.

Gjykata në lidhje me këtë çështje ka konstatuar vetëm faktin e gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, dhe nuk është lëshuar lidhur me të drejtën e posedimit, bazën juridike, ndërjegjeshmërinë apo pandërgjegjshmërinë e posedimit.

Gjendjen e fundit të posedimit, gjykata e konstatoi nga deklaratimet e paditësit dhe dëshmitarit të dëgjuar gjatë këtij procesi, nga të cilët u bind se në pronën kontestuese me qëllim të rregullimit të rrjetit të kanalizimit janë vendosur gypat e kanalizimit dhe vendosja e pusetës, e cila punë është ndërprerë nga i padituri. Fakt tjetër për të vërtetuar gjendjen e fundit të posedimit nga ana e paditësit, gjykata mori edhe dëshminë e dëshmitarit Elver Shabani, i cili si punëtor i KRU “Hidromorava”, pohoi faktin e vendosjes së gypave të kanalizimit dhe pusetës sipas standartit të kërkuar, dhe se gjatë punimeve të vendosjes së gypave të cilat i ka mbikëqyrë edhe dëshmitari nuk ka ndërhyrë ndonjë pronarë.

Fakt kyq për të vërtetuar gjendjen e fundit të posedimit, gjykata mori edhe deklaratimin e të paditurit në përgjegjen në padë, gjatë seancave gjyqësore dhe në shpjegimet përfundimtare, i cili gjatë tërë procesit kontestimorë ka pohuar të ketë penguar paditësin në vendosjen e pusetës në pronën e tij, këtu pronën kontestuese, nën arsyetimin se me këtë veprim të paditurit i janë cenuar autorizimet pronësore. Nga ky deklaratim gjykata gjeti se në këtë pronë, gjendjen e fundit të posedimit e ka pasur paditësi, i cili në bazë të kërkesës së tij për vendosjen e gypave dhe të pusetës, kyqjen në rrjetin e kanalizimit e ka bërë Kompania “Hidromorava”, në bazë të autorizimeve të tyre.

Pengimin e bërë gjykata e konstatoi edhe nga vet pohimi i të paditurit, prandaj duke u bazuar në nenin 321.2 të LPK-së, ku shprehimisht parashihet se “*Nuk ka nevoj të provohen faktet të cilat pala i ka pohuar para gjykatës gjatë procesit gjyqësor*” nuk u lëshua në vërtetimin e mëtejshëm të gjendjes faktike sa i përket pengimit të bërë nga i padituri pasi gjendja e tillë u pohua vet nga i njejti.

Në rastin konkret duke vërtetuar se deri me dt.02.12.2022 posedues i fundit i sipërfaqes së cekur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi ka qenë paditësi, ku pastaj i padituri paditësin e ka privuar dhe penguar në kyqjen e kanalizimit dhe vendosjen e pusetës sipas standarteve të kërkuara në atë mënyrë që më dt. 02.12.2022 i njejti e ka penguar paditësin në kyqjen e rrjetit të kanalizimit dhe vendosjen e pusetës së lartëcekur, duke vazhduar me pengimin e posedimit edhe më datë 03,04 dhe 05.12.2022 e tutje. I padituri me qëllim të pengim posedimit në vendin e ngjarjes ka angazhuar një punëtorë të sigurimit me qëllim që

mos ta lejoj paditësin në vendosjen e kësaj pusete dhe lidhjen e kanalizimit, për cka paditësi e ka njoftuar edhe policinë për këtë fakt. Se pengimi i posedimit ka vazhduar nga i padituri

vërtetohet edhe me aktgjykimin Pnr.218/2023, me të cilën ndaj të pandehurve I D nga fsh.U dhe B Ai nga fsh.M e E, është pranuar urdhëri ndëshkimor për shkak të veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe janë dënuar me dënim me gjobë në shumë prej 150.00€, për secilin veç e veç për shkak të njejtimit më datë 21 janar 2023, rreth orës 12.27min në rrugë.

Gjykata ekspertizës në fjalë ia fali besimin, pasiqë e njëjta ishte e punuar në mënyrë profesionale, në bazë të rregullave të shkencës dhe profesionit, nuk pati kundërshtime nga palët ndërgjyqëse e poashtu ishte edhe në përputhje me gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata me rastin e daljes në vendngjarje.

Andaj gjykata nga gjendje faktike e vërtetuar dhe duke gjetur mbështetje në dispozitat e lartëcekura vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi nga gjendja faktike si më lartë dhe bazuar nenin 113 të LPDTS-së pasi vlerësoj se veprimet e lartëcekura janë veprime penguese nga ana e të paditurit, i cili e ka penguar paditësin që të bëjë kyqjen në rrjetin e kanalizimit dhe vendosjen e një pusete në pjesën ku bëhet kjo kyqje, në parcelën me numër 4945-9 ZK-Gjilan.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi në bazë të 452.1 të LPK-së ku parashihet se „ Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore,, prandaj e detyroi të paditurin që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet gjyqësore edhe atë për përpilimin e padisë 104€, për taksë gjyqësore për padi 50 €, për shtatë seanca të mbajtura nga 135€, për një seancë si dhe 162.00 € ekspertizën gjeodezike, të gjitha këto në shumë të përgjithshme 1,261.00€. Shpenzimet për shpërblimin e punës së avokatit u bazuan në Rregulloren për Tarifa të OAK.

Prandaj, nga të lartëcekurat duke përfshirë gjendjen faktike, dispozitat ligjore, bindjen e lirë të gjykatës dhe bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata Themelore Në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 1328/2022, datë 19.02.2024

Gjyqtarja,
Floriqe Qerimi

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit. Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.